VENDIM
Nr.219, datë 6.3.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1703, DATË 24.12.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR VENDOSJEN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE DHE TË VEPRIMTARIVE SEZONALE/TË PËRKOHSHME, PËR MINISTRITË DHE INSTITUCIONET BUXHETORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 4 e vendimit nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha